



**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 186 Datë 10.11.2017

**MBI
MIRATIMIN E KODIT TË TRANSMETIMIT**

Në mbështetje të neneve 16, 56, gërma “g” dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për miratimin e “Kodit të Transmetimit”,

Konstatoi se,

- Në përputhje me përcaktimet e neneve 56, gërma “g” dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”: “Operatori i Sistemit të Transmetimit harton dhe publikon Kodin e Transmetimit”; “Operimi i sistemit të transmetimit kryhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit, i cili hartohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, në përputhje me kërkesat e Kodit të Rrjetit të ENTSO-e dhe miratohet nga ERE”
- Bordi i ERE me Vendimin nr. 2, datë 27.01.2016, filloi procedurat për miratimin e “Kodit të Transmetimit”.
- ERE me shkresën Nr. 26/6 prot., datë 03.02.2016, publikoi për 3 ditë me rradhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të Bordit, duke filluar nga data 4 Shkurt 2016.
- Me shkresën nr. 2661/2 Prot., datë 07.06.2016 ka dërguar në ERE versionin 1.2 të riorganizuar të draft Kodit të Transmetimit në zbatim të zhvillimeve më të fundit të ENTSO-E lidhur me kodin e gjenerimit.
- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 236/1 Prot., datë 21.07.2016 shprehet se: projekt “Kodi i Transmetimit” nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

- 1 Të miratojë Kodin e Transmetimit (Bashkëlidhur)
- 2 Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI